


# Planifikimi i qëndrueshëm urban në Obiliq

## Abstrakt

Shkalla e shpejtë e urbanizimit pas revolucionit industrial ka shkaktuar një seri të madhe ndryshimesh në botë (UNHS, 2011). Përpjekja njerëzore për të arritur një cilësi më të lartë të jetës dëmton mjedisin në shkallë lokale dhe globale. Pas krizës globale mjedisore (d.m.th. ngrohja globale, ndryshimet klimatike dhe shpyllëzimi i përhapur), axhenda e qëndrueshmërisë është bërë një nga temat më të diskutueshme të shekujve 20 dhe 21 (UNHS, 2011). Rreth 50 përqind e popullsisë globale sot jeton në zona urbane (Anguluri dhe Narayanan, 2017). Rritja e popullsisë dhe e urbanizimit si procese njëkohsishtë janë bërë dy sfidat më të cilat po përballet mjedisi gjithandej. Qytetet, si vendbanimet më kompakte të njerëzve, kanë një efekt të jashtëzakonshëm në ndryshimet mjedisore (Girardet dhe Schumacher, 1999). Në debatin se si duhet të bëhet planifikimi urban ka një histori të gjatë të asaj që përbën një qytet të qëndrueshëm që filloi qysh në fund të shekulli i nëntëmbëdhjetë (Breheny, 1998). Një problem global në kontekstin e qyteteve të qëndrueshëm është se qytetet e botës kryesisht kontribuojnë në një zhvillim të paqëndrueshëm dhe jo në një të qëndrueshëm. Historikisht, debati për planifikimin urban ka qenë i përbërë nga argumente rurale kundrejt atyre urbane, lidhur me mënyrën se si dhe ku njerëzit duhet dhe duan të jetojnë (Breheny, 1998).

Në fillim le të shohim se Çfarë është një qytet i qëndrueshëm?

Në përgjithësi pranohet se trilogjia e ekonomisë, mjedisit dhe barazisë sociale janë komponentët kryesorë të konceptit të qëndrueshmërisë (Chan dhe Lee, 2008; Girardet dhe Mendonca, 2009). Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin (WCED) vendosi përkufizimin e zhvillimit të qëndrueshëm si "një zhvillim që plotëson nevojat e brezit aktual pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre" (1987). Në këtë kontekst, Moore (2007) pohon se ekziston një konflikt trekëndor midis ekonomisë, ekologjisë dhe barazisë si kontribuesit kryesorë të qëndrueshmërisë në drejtim të arritjes së strategjisë. Kërkohej një ekuilibër midis diskutimeve të zhvillimit, pronës dhe burimeve për të arritur një qëndrueshmëri të integruar në një kontekst urban. Një bilanc i tillë ka më shumë mundësi për ta bërë qytetin më fitimprurës, më të drejtë dhe më të gjelbër për palët e interesit, zhvilluesit dhe qeveritarët (Figura 1).



**Figura 1. Konflikti trekëndor midis kontribuesve kryesorë për të arritur qëndrueshmërinë**  
(Moore, 2007)

Në vitin 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Rezolutën për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe themeloi Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm. Në këtë mënyrë, Kosova u zotua për zhvillimin e treguesve të saj kombëtarë për të ndihmuar në monitorimin e progresit të arritur në objektivat dhe synimet e saj. Përpjekjet e qeverisë qendrore dhe lokale janë thelbësore për t'i arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Qeveria lokale duhet t'i trajtojë çështjet që lindin nga Objektiva e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe të punojnë drejt progresit të kërkuar. Detyrat si planifikimi hapësinor, mirëqenia sociale, mirëmbajtja e rrugëve lokale, transporti publik, menaxhimi i mbeturinave, ujit dhe kanalizimit etj., janë detyrat më të zakonshme për pothuajse

çdo nivel lokal. Qeverisë qendrore i takon që të sigurojë burime për adresimin e nevojave, ndërsa përgjegjësia bie mbi pushtetin lokal që të sigurojnë që ato burime të përdoren për arritjen e OZHQ-ve, në mënyrë efikase dhe efektive. Kjo e vë pushtetin lokal në rolin e akterëve kryesorë në procesin e arritjes së OZHQ-ve. Për këtë qëllim, Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale ka harmonizuar një numër të treguesve të tij për të kontribuar drejtpërdrejt në arritjen e OZHQ-ve. Realisht zhvillimi i qëndrueshëm është një tematik e re për Kosovën dhe kjo mund të shihet në paratë e dedikuara për zhvillimin e qëndrueshëm dhe qëllimet e brendshme të saj. Kosova është gjithashtu një vend në zhvillim, i cili po kalon në fazën e tranzicionit në shumë fusha. Prandaj, kjo mund të jetë një sfidë shtesë në zbatimin e politikës së qëndrueshme të planifikimit urban, pasi lidhet me atë se si planifikohet një jetë e qëndrueshme.